



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVES REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO	
KUVENDI KOMUNAL ASSEMBLY OF MUNICIPALITY SKUPŠTINA OPŠTINE	
SKENDERAJ	
Nr.	
No.	02-020/01-0049114/25
Data.	
Data.	17.11.2025



Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality of Skenderaj

Zyra e Kryetarit /Kabinet Predcednika / Office of the Mayor

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 shkronja a) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, sipas kërkesës së DUMA-së, menaxherit të kontratës Visar Hyseni Nr.06-351/01-0048492/25 të datës 11.11.2025, dhe sipas nenit 15 të Statutit të Komunës së Skenderajt Nr.01-110-385 të datës 03.12.2008, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M
(Për formimin e komisionit)

1. Formohet komisioni për riformatim dhe punë shtesë të projektit: "Riparimi dhe rregullimi i parkut "Idriz Rreci" në Skenderaj, në këtë përbërje:

- 1.1 Valentina Aliu, kryesuese
- 1.2 Sherife Elshani, anëtare
- 1.3 Arbenita Aruqi, anëtare

2. Detyrë e komisionit është që në mënyrë profesionale dhe objektive të bëjë vlerësimin rreth paraqitjes së nevojshmërisë për riformatim dhe punë shtesë të projektit të cekur në pikën 1 të këtij vendimi, konform gjendjes në terren, dhe sipas paramasës të paraqitura nga menaxheri i kontratës Visar Hyseni.

3. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

Vendimi i'u dërgohet:

- Arkivit
- DUMA-së
- DPP-së
- Anëtarëve të komisionit





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVES REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO KUVENDI KOMUNAL ASSEMBLY OF MUNICIPALITY SKUPŠTINA OPŠTINE SKENDERAJ
Nr.
No. 02-020/01-0048449/25
Data.
Data. 11. 11. 2025



Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality of Skenderaj

Zyra e Kryetarit /Kabinet Predcednika / Office of the Mayor

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 shkronja a) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, sipas kërkesës së DUMA-së Nr.06-352/04-0046702/25 të datës 28.10.2025, dhe sipas nenit 15 të Statutit të Komunës së Skenderajt Nr.01-110-385 të datës 03.12.2008, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M

(Mbi emërimin e anëtarëve të komisionit)

- I. **Emërohen** anëtarët e komisionit për prerjen e punimeve dhe pranimin teknik të punimeve të kryera deri me tani të projektit me titull: “Rregullimi i shtratit të lumit Klinë e Ulët - Kuçicë”, me nr. të kontratës: 643-23-2659-5-1-1/C396, në këtë përbërje:
 1. Hajzer Shala, kryesues
 2. Albulena Lushtaku Ahmetaj, anëtare
 3. Agron Haxha, anëtar
- II. Detyrë e komisionit është që në mënyrë objektive dhe profesionale të bëj prerjen e punimeve dhe pranimin teknik të punimeve të kryera deri me tani të projektit të cekur në pikën I të këtij vendimi.
- III. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi shfuqizohet vendimi Nr.02-020/01-0047814/25 të datës 05.11.2025, sipas nenit 53 parag.1 dhe 3, nenit 57 parag.1 dhe nenit 58 parag.1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të tij.

Vendimi i dërgohet:

- Arkivit
- DUMA-së
- Anëtarëve të komisionit





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVES REPUBLICA OF KOSOVO REPUBLIQUE DU KOSOVO KUVENDI KOMUNAL ASSEMBLY OF MUNICIPALITY SKENDERAJ	
Nr.	
No.	02-020/01-0047819/25
Data.	
Data.	05.11.2025



Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality of Skenderaj

Zyra e Kryetarit /Kabinet Predcednika / Office of the Mayor

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 shkronja a) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, pas shqyrtimit të kërkesës së DUMA-së të datës 03.11.2025, dhe sipas nenit 15 të Statutit të Komunës së Skenderajt Nr.01-110-385 të datës 03.12.2008, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M
(Për formimin e komisionit)

I. Formohet komisioni për pranim teknik të kontratës me titull: "Ndërtimi i rrugës Syriganë - Bjeshket e Syriganës" Komuna e Skenderajt me nr.prokurimi: 643-23-9793-5-1-1, (sipas kërkesës me nr.14-370/02-0046419/25 të datës 27.10.2025), në këtë përbërje:


1. **Sanije Ahmeti** (nga DUMA), kryesuese
2. **Agron Beshiri** (nga MMPHI), anëtar
3. **Sherife Elshani** (nga DUMA), anëtare

II. Detyrë e komisionit është që në mënyrë objektive dhe profesionale të bëjë pranimin teknik të kontratës të cekur në pikën I të këtij vendimi.

III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

Vendimi i'u dërgohet:

- Arkivit
- DUMA-së
- Anëtarëve të komisionit





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KUVENDI KOMUNAL/ASSEMBLY OF MUNICIPALITY/SKUPSTINA OPSINA
SKENDERAJ

Nr. 02-020/01-0047815/25
No.
Data 05.11.2025
Date



Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality of Skenderaj

Zyra e Kryetarit/Kabinet Predcednika/Office of the Mayor

Në bazë të nenit 13 dhe 58 shkronja a) të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, ndërlidhur me nenin 81 të Ligjit nr.04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-237, Ligjin nr.05/L-068 dhe Ligjin nr.05/L-092, konform nenit 70 paragrafi 70.18 dhe 70.19 të Rregullores Nr.001/2022 për Prokurimin Publik, si dhe nenit 15 të Statutit të Komunës së Skenderajt Nr.110-385, të datës 03.12.2008, pas shqyrtimit të Kërkesës Nr.13-020/01-0040326/25, dt. 09.09.2025, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M

Për caktimin e menaxherit të kontratës dhe mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës

- I. Caktohet menaxheri i kontratës dhe mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i menaxherit të projektit / kontratës për tenderin me titull: **“037- Asfaltimi i rrugëve në fshatrat Kuqicë, Qubrel, Kostërc, Vitak, Klladërnice, Burojë, Vajnik, Abri, Ticë, Klinë, Prekaz, Skenderaj”**, si vijon:
 1. **z.Refki Haliti** - caktohet **menaxher** i kontratës sipas pikës I të këtij vendimi.
 2. **znj.Antigona Miftari**, caktohet **mbikëqyrëse** e drejtpërdrejtë e menaxherit të kontratës sipas pikës I të këtij vendimi.
- II. Menaxheri i kontratës dhe mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës, obligohen që të bëjnë administrimin dhe menaxhimin e implementimit të kontratës në pajtim me nenin 70 paragrafi 70.17, 70.23, 70.24 dhe 70.25 të Rregullores Nr.001/2022 për Prokurimin Publik.
- III. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, shfuqizohen: Vendimi Nr.02-020/01-0043754/24, dt. 05.09.2024, Vendimi Nr. 02-020/01-0016704/25, dt. 06.05.2025 dhe Vendimi 02-020/01-0023083/25, dt. 19.06.2025.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Vendimi i dërgohet:

- Arkivit
- DPP- së
- DUMA-së
- Menaxherit
- Mbikëqyrësit





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KUVENDI KOMUNAL/ASSEMBLY OF MUNICIPALITY/SKUPŠTINA OPŠTINA
SKENDERAJ

Nr. 02-020/01-0047818/25
Data 05 11 2025



Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality of Skenderaj

Zyra e Kryetarit/Kabinet Predcednika/Office of the Mayor

Në bazë të nenit 13 dhe 58 shkronja a) të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, ndërlidhur me nenin 81 të Ligjit nr.04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-237, Ligjin nr.05/L-068 dhe Ligjin nr.05/L-092, konform nenit 70 paragrafi 70.18 dhe 70.19 të Rregullores Nr.001/2022 për Prokurimin Publik, si dhe nenit 15 të Statutit të Komunës së Skenderajt Nr.110-385, të datës 03.12.2008, pas shqyrtimit të Kërkesës Nr.13-020/01-0040326/25, dt. 09.09.2025, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M

Për caktimin e menaxherit të kontratës dhe mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës

- I. Caktohet menaxheri i kontratës dhe mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i menaxherit të projektit / kontratës për tenderin me titull: **“022- Asfaltimi i rrugëve në fshatrat Klinë, Polac, Makërmal, Ticë, Kopiliq i Epërm dhe Rakinicë”**, si vijon:
 1. **z.Refki Haliti** - caktohet **menaxher** i kontratës sipas pikës I të këtij vendimi.
 2. **znj.Antigona Miftari**, caktohet **mbikëqyrëse** e drejtpërdrejtë e menaxherit të kontratës sipas pikës I të këtij vendimi.
- II. Menaxheri i kontratës dhe mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës, obligohen që të bëjnë administrimin dhe menaxhimin e implementimit të kontratës në pajtim me nenin 70 paragrafi 70.17, 70.23, 70.24 dhe 70.25 të Rregullores Nr.001/2022 për Prokurimin Publik.
- III. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, shfuqizohen: Vendimi Nr.02-020/01-0026238/24, dt. 04.06.2024, Vendimi Nr.02-020/01-0042211/24, dt.28.08.2024 dhe Vendimi 02-020/01-0043975/24, dt. 09.09.2024.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.


Vendimi i dërgohet:

- Arkivit
- DPP- së
- DUMA-së
- Menaxherit
- Mbikëqyrësit





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality of Skenderaj

Zyra e Kryetarit/Kabinet Predcednika/Office of the Mayor

Në bazë të nenit 13 dhe 58 shkronja a) të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, sipas nenit 81 të Ligjit nr.04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-237, Ligjin nr.05/L-068 dhe Ligjin nr.05/L-092, konform nenit 70 paragrafi 70.18 dhe 70.19 të Rregullores Nr.001/2022 për Prokurimin Publik, e Plotësuar dhe Ndryshuar me Rregulloren Nr.002/2024, sipas kërkesës së DPP-së Nr.14-020/01-0048572/25 të datës 11.11.2025, dhe nenit 15 të Statutit të Komunës së Skenderajt Nr.110-385, të datës 03.12.2008, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M

Për caktimin e menaxherit të kontratës dhe mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës

- I. Caktohet menaxheri i kontratës dhe mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i menaxherit të projektit/kontratës për tenderin me titull: "044 - Pastrimi dhe mirëmbajtja e rrugëve në territorin e Komunës së Skenderajt gjatë sezonit dimëror", me nr.prokurimi: 643-25-7858-2-1-1.**
 - 1. z.Hajzer Shala, caktohet menaxher i kontratës sipas pikës I të këtij vendimi.**
 - 2. z.Zenel Deliu, caktohet mbikëqyrës i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës sipas pikës I të këtij vendimi.**
- II. Menaxheri i kontratës dhe mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës, obligohen që të bëjnë administrimin dhe menaxhimin e implementimit të kontratës në pajtim me dispozitat e Rregullores Nr.001/2022 për Prokurimin Publik të plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren Nr.002/2024.**
- III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.**


Vendimi i'u dërgohet:

- Arkivit
- DPP-së
- Menaxherit
- Mbikëqyrësit





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality of Skenderaj

Zyra e Kryetarit /Kabinet Predcednika / Office of the Mayor

Mbështetur në nenin 13 dhe nenin 58 pika a) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, nenin 15 të Statutit të Komunës së Skenderajt Nr.110-385, të datës 03.12.2008, ndërlidhur me nenin 11 paragrafi 2 të Ligjit Nr.06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike, në përputhje në plotë me Ligjin Nr.06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M

- I. **Aprovohet** kërkesa e datës 16.10.2025 për qasje në dokumente publike, e parashtruar në formë elektronike nga Portali "Rajoni.org", dhe i **lejohe**t qasje në të dhënat e kërkuara, në pajtim me Ligjin 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.
- II. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Komuna e Skenderajt, e përfaqësuar nga Kryetari i Komunës z.Fadil Nura, në momentin e njoftimit me kërkesën për qasje në dokumente publike, të datës 16.10.2025, të parashtruar në formë elektronike nga Portali "Rajoni.org", ka filluar shqyrtimin e kësaj kërkesë. Në kërkesën e parashtruar është kërkuar qasje në listën e pagave dhe shtesave të realizuara gjatë periudhës së pandemisë për vitin 2020, 2021, 2022 dhe çdo kompensim tjetër i përfshirë në atë periudhë për zyrtarët e administratës së QKMF-së, sipas listës së bashkëngjitur kërkesës dhe këtij vendimi. Kryetari i Komunës pas shqyrtimit të kërkesës në fjalë, në mbështetje të nenit 11, paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit Nr.06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike, ndërlidhur me Ligjin Nr.06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, si dhe në zbatim të parimit të konfidencialitetit, vendosi që Portalit "Rajoni.org" t'i ofrohet qasje e plotë në të dhënat e kërkuara, por duke hequr apo anonimizuar të dhënat personale të zyrtarëve.

Nga ajo që u tha më lart, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të paraqesë ankesë në Agjencinë për Informim dhe Privatësi, brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga dita e pranimit të tij.


Vendimi i dërgohet:

- Arkivit
- Zyrtarit të QDP-së
- Palës





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality of Skenderaj

Zyra e Kryetarit /Kabinet Predcednika / Office of the Mayor

Duke u bazuar në nenin 13 dhe nenin 58 shkronja a) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenin 46 të Ligjit Nr.04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, i Ndryshuar dhe Plotësuar me Ligjin Nr.04/L-237, Ligjin Nr.05/L-068, dhe Ligjin Nr.05/L-09, konform Rregullores 002/2024 për Plotësimin dhe Ndryshimin e Rregullores Nr.001/2022 për Prokurimin Publik, sipas nenit 15 të Statutit të Komunës së Skenderajt Nr.110-385 të datës 03.12.2008, dhe sipas kërkesës së DSHP-së Nr.09-370/01-0048731/25 të datës 12.11.2025, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M

- I. **LEJOHET** zhvillimi i procedurave tenderuese me afatet e përshpejtuara kohore për realizimin e projektit me titull: **“Furnizim dhe mbjellje e drunjëve dekorativ për gjelbërimin e qytetit”**.
- II. **Obligohet** Drejtoria e Prokurimit Publik që në bazë të dispozitave ligjore në fuqi, të bëjë zhvillimin e procedurave të tenderimit me afate të përshpejtuara kohore, për realizimin e projektit sipas pikës I të këtij vendimi.
- III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

Vendimi i'u dërgohet:

- Arkivit
- DPP-së
- DSHP-së





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KUVENDI KOMUNAL/ASSEMBLY OF MUNICIPALITY/SKUPŠTINA OPŠTINA
SKENDERAJ

Nr. 02-370/01-0049892/25
Data 24.11.2025



Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality of Skenderaj

Zyra e Kryetarit /Kabinet Predcednika / Office of the Mayor

Duke u bazuar në nenin 13 dhe nenin 58 shkronja a) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, sipas nenit 46 të Ligjit Nr.04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, i Ndryshuar dhe Plotësuar me Ligjin Nr.04/L-237, Ligjin Nr.05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, konform nenit 45 paragrafi 45.6 të Rregullores Nr.001/2022 për Prokurimin Publik të datës 20.10.2022 e Plotësuar dhe Ndryshuar me Rregulloren Nr.002/2024, sipas nenit 15 të Statutit të Komunës së Skenderajt Nr.110-385, të datës 03.12.2008, dhe sipas kërkesës së DShMS-së Nr. 08-370/01-0049574/25, të datës 20.11.2025, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M

(Mbi zbatimin e përdorimit të afateve të përshpejtuara kohore)

- I. **LEJOHET** zbatimi i përdorimit të afateve të përshpejtuara kohore për procedurën e tenderimit për projektin me titull: **“Servisimi i Pajisjeve Radiologjike në QKMF”**.
- II. **Obligohet** Drejtoria e Prokurimit Publik që në bazë të dispozitave ligjore në fuqi, të zbatojë përdorimin e afateve të përshpejtuara kohore për procedurën e tenderimit për projektin sipas pikës I të këtij vendimi.
- III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Vendimi i dërgohet:

- Arkivit
- DShMS-së
- DPP-së





REP. E KOSOVES REPUBLIKA E KOSOVO REPUBLIC OF KOSOVO
KUVENDI KOMUNAL ASSEMBLY OF MUNICIPALITY SKUPŠTINA OPŠTINE
SKENDERAJ

Nr. _____
No. 02-020/01-0048667/25
Data. _____
Data. 13.11.2025



Republika e Kosovës

Komuna Skenderaj

Republika Kosova
Republic of Kosovo

Opština Skenderaj
Municipality of Skenderaj

Zyra e Kryetarit /Kabinet Predcednika / Office of the Mayor

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 shkronja a) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, ndërlidhur me nenin 15 të Statutit të Komunës së Skenderajt Nr.01-110-385, të datës 03.12.2008, pas shqyrtimit të Kërkesës së DUMA-së Nr.06-020/01-0048667/25, të datës 12.11.2025, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M

(Për formimin e komisionit)

I. Formohet komisioni për inspektimin e gjendjes në terren për objektet e legalizimit, në këtë përbërje:

1. **Hetem Dajaku**, kryesues
2. **Valentina Jashari**, anëtare
3. **Sherife Elshani**, anëtare

II. Detyrë e komisionit është që në mënyrë profesionale të bëjë inspektimin e gjendjes në terren për objektet e legalizimit, konform legjislacionit në fuqi.

III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.



Vendimi i dërgohet:

- Arkivit
- DUMA-së
- Anëtarëve të komisionit



Kryetari i Komunës

Fadil Nuja



Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality of Skenderaj

Zyra e Kryetarit /Kabinet Predcednika / Office of the Mayor

Duke u bazuar në nenin 13 dhe 58 shkronja a) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, ndërlidhur me nenin 50 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, konform nenit 15 të Statutit të Komunës së Skenderajt, Nr.110-385 të datës 03.12.2008, pas shqyrtimit të Propozimit të DPP-së Nr.14-020/01-0048279/25, të datës 10.11.2025, Kryetari i Komunës merr këtë:

VENDIM

- I. Miratohet ndryshimi dhe plotësimi i Vendimit Nr.02-020/01-0046894/25, i datës 30.10.2025, për caktimin e komisionit për vlerësimin e ofertave për projektin me titull: **“Ndërtimi i Kolektorit Llaushë – Tushilë – Aqarevë në Komunën e Skenderajt”**, me numër prokurimi 643-25-2953-5-1-1.
- II. Në nenin I të vendimit bazë, Komisioni plotësohet me dy anëtarë (ekspert), si në vijim:
4. Bekim Latifi - anëtar
5. Sabri Ymeri - anëtar
- III. Pjesa tjetër e Vendimit Nr.02-020/01-0046894/25, të datës 30.10.2025 mbetet e pandryshuar.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Vendimi i dërgohet:

- Arkivit
- DUMA-së
- DPP-së
- anëtarëve





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KUVENDI KOMUNAL/ASSEMBLY OF MUNICIPALITY/SKUPSTINA OPŠTINE
SKENDERAJ

Nr. 02-034/09-0049119/25
Data 17.11.2025



Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality of Skenderaj

Zyra e Kryetarit /Kabinet Predcednika / Office of the Mayor

Mbështetur në nenin 13 dhe nenin 58 pika a) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, nenin 15 të Statutit të Komunës së Skenderajt Nr.110-385, të datës 03.12.2008, ndërlidhur me nenin 11 paragrafi 2 të Ligjit Nr.06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike, në përputhje në plotë me Ligjin Nr.06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M

- I. **Aprovohet** kërkesa e datës 30.11.2025 për qasje në dokumente publike, e parashtruar në formë elektronike nga Portali "Rajoni.org", dhe i **lejohet qasje** në të dhënat e kërkuara, duke anonimizuar të dhënat personale në pajtim me Ligjin 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.
- II. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Komuna e Skenderajt, ka pranuar dhe shqyrtuar kërkesën për qasje në dokumente publike të datës 30.11.2025, të parashtruar në formë elektronike nga Portali "Rajoni.org". Në kërkesën e parashtruar është kërkuar qasje në dokumentet si në vijim:

1. Listën e plotë të shëfave të shërbimeve në QKMF (urgjencë, kujdes parësor, stomatologji, laborator, etj);
2. Listën e përgjegjësve të QKMF-ve në territorin e Komunës së Skenderajt;
3. Listën e stafit administrativ dhe pozitat e tyre në QKMF dhe QMF;
4. Konkursin e shpallur për secilin shëf shërbimi në QKMF, listën e kandidatëve që kanë aplikuar, procesverbalin e testit me shkrim dhe procesverbalin e intervistimit të kandidatit të përzgjedhur dhe vendimin me të cilin është emëruar.

Kryetari i Komunës pas shqyrtimit të kërkesës në fjalë, në mbështetje të nenit 11, paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit Nr.06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike, ndërlidhur me Ligjin Nr.06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, si dhe në zbatim të parimit të konfidencialitetit, vendosi që Portalit "Rajoni.org" t'i ofrohet qasje e plotë në të dhënat e kërkuara, por duke hequr apo anonimizuar të dhënat personale në pajtim me Ligjin 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Nga ajo që u tha më lart, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të paraqesë ankesë në Agjencinë për Informim dhe Privatësi, brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga dita e pranimit të tij.

Vendimi i dërgohet:

- Arkivit
- Zyrtarit të QDP-së
- Palës

